



Universiteti Publik "Kadri Zeka" Public University	
Pranuar nga	12.12.2023
Nr. i	01 2842



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në Prishtinë, në mes të palëve kontraktuese:

- I. **BANKA PËR BIZNES Sh. A.**, shoqëri aksionare e regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 70062470 dhe me adresë të regjistruar në Rruga UÇK Nr. 153, 10000 Prishtinë (këtu e tutje referuar si "**Banka**")
dhe
- II. **UNIVERSITETI "Kadri Zeka" Gjilan**, Universitet publik, me adresë Rruga Zija Shemsiu pn. 60000 Gjilan, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku, (këtu e tutje referuar si "**Universiteti**")

Këtu e tutje kjo Marrëveshje Bashkëpunimi referuar si "**Marrëveshja**" ndërsa Banka dhe Universiteti i Gjilanit së bashku referuar si "**Palët**".

Recitalet

Duke pasur parasysh se, Banka është e licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të zhvilluar aktivitetin e vet bankar/financiar në Kosovë;

Duke pasur parasysh se, Universiteti është akredituar nga Qeveria e Kosovës dhe me Statut të miratuar në Kuvendin e Kosovës për të ofruar arsimin e lartë në Republikën e Kosovës;

Duke pasur parasysh recitalet e kësaj Marrëveshje, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje, Palët janë pajtuar si në vijim:

Neni 1 OBJEKTI I MARRËVESHJES

Me këtë Marrëveshje, Palët janë pajtuar që Banka të ofrojë mundësi të praktikës dhe angazhimit për studentët më saktësisht mundësi për tu berë pjesë e programit Junior kurse Universiteti të ofrojë rekomandime për studentët e dalluar dhe mundësi që banka të mbajë sesione informuese rreth punës praktike.

Neni 2 KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga Palët dhe njëjta mbetet në fuqi deri në shkëputjen e saj nga Banka dhe/apo Universiteti, sipas kushteve të termeve të përcaktuara me këtë Marrëveshje.



Neni 3 KUSHTET E BASHKËPUNIMIT

- 3.1** Kjo Marrëveshje është e aplikueshme dhe përfshinë mbrojtjen e interesit afarist të të dy palëve në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen dhe ngritjen e reputacionit të ndërsjelltë.
- 3.2** Palët janë pajtuar që objekti i kësaj marrëveshje mund të zgjerohet edhe në forma të tjera të bashkëpunimit. Me këtë rast palët do të nënshkruajnë shtojcë të veçantë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi në formë të shkruar.
- 3.3** Palët janë pajtuar që gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje bashkëpunimi studentët e Universitetit do të kenë mundësinë që nën kushte të caktuara të marrin pjesë në punë praktike dhe angazhim në departamente ose degë të ndryshme të bankës për një periudhë të caktuar kohore pas përfundimit të praktikës, ndërsa pas përfundimit të suksesshëm do të pajisen me një vërtetim për përfundimin e punës praktike.

Neni 4 TË DREJTAT, DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË E UNIVERSITETIT

- 4.1** Universiteti obligohet që të ofrojë informacion të saktë për studentët e tij në lidhje me mundësitë e punës praktike që do të ofrohen për studentët.
- 4.2** Universiteti duhet të sigurohet se studentët janë të kualifikuar dhe të gatshëm për të kryer punë praktike në institucionin bankar.
- 4.3** Universiteti rekomandohet të ketë një koordinator i cili do të krijojë dhe menaxhojë marrëdhëniet mes universitetit dhe bankës.
- 4.4** Palët janë pajtuar që gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, Universiteti do t'i mundësojë Bankës që në objektet e tij të organizojë dhe mbajë takime fizike dhe/apo virtuale me studentë si: seminare, panairë, pjesëmarrje në ligjerata dhe sesione informuese në mënyrë që studentët të njohohen nga afër rreth mundësive të punësimit që ofron Banka.
- 4.5** Universiteti obligohet që të veprojë në përputhje me praktikën e afarizmit korrekt dhe të ndërmarrë me kohë masa për parandalimin e çfarëdo dëmi që mund t'i shkaktohet reputacionit të Bankës nga punësimet eventuale sipas kësaj Marrëveshje.



- 4.6** Universiteti obligohet të bëjë promovimin e kësaj Marrëveshje dhe mundësive të punësimit sipas kësaj Marrëveshje në rrjetet sociale dhe format tjera të marketingut, të cilat i shfrytëzon për reklamimin e produkteve dhe shërbimeve të veta.

Neni 5 TË DREJTAT, DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË E BANKËS

- 5.1** Banka merr përsipër që t'i jep udhëzime të qarta Universitetit të Gjiilanit me qëllim të realizimit të kësaj Marrëveshje.
- 5.2** Banka ka të drejtë që të vendos nëse pranon apo jo studentët e universitetit për punë praktike, gjithmonë duke respektuar meritokracinë dhe kriteret e pranimit në punë praktike.
- 5.3** Banka ka të drejtë që të kërkojë nga studentët që të respektojnë rregulloret dhe procedurat e saj gjatë kohës së kryerjes së punës praktike.
- 5.4** Banka ka të drejtë që në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje, të bëjë reklamim sa i përket cilësisë së përbushjes së detyrimeve nga Universiteti sipas kushteve të kësaj Marrëveshje.
- 5.5** Banka ka të drejtë të shkëpus këtë Marrëveshje me njoftimin paraprak me shkrim, prej së paku tridhjetë (30) ditësh. Pavarësisht kësaj, studentët e punësuar në momentin e ndërprerjes së kësaj Marrëveshje do të vazhdojnë punën sipas kushteve të kontratës së tyre të nënshkruar me Bankën edhe pas shkëputjes/ndërprerjes së kësaj Marrëveshje, deri në skadimin e kontratës së punës.

Neni 6 SHKËPUTJA E MARRËVESHJES

- 6.1** Banka dhe Universiteti pajtohen se mund të përfundojnë këtë Marrëveshje pas konstatimit nga ndonjë autoritet publik/shtetëror me juridiksion kompetent në Republikën e Kosovës mbi Palët dhe mbi këtë Marrëveshje, se kjo Marrëveshje është në kundërshtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën Kosovës.
- 6.2** Banka dhe Universiteti mund të shkëpusin këtë Marrëveshje me njoftimi paraprak me shkrim të dërguar së paku tridhjetë (30) ditë para datës në të cilën synohet të shkëputet kjo Marrëveshje. Pavarësisht kësaj, Palët obligohen t'i përbushin obligimet reciproke deri në momentin e shkëputjes së kësaj Marrëveshje.



Neni 7 CEDIMI DHE NËN KONTRAKTIMI

- 7.1** Universiteti nuk mund të nënkontrakttojë, caktojë, transferojë dhe/ose cedojë ndonjë apo të gjitha të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshje të ndonjë palë e tretë, përveç kur autorizohet me shkrim nga Banka.
- 7.2** Banka ka të drejtë të nënkontrakttojë, caktojë, transferojë dhe/ose cedojë ndonjë apo të gjitha të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshje të ndonjë palë e tretë, pa pasur nevojë për çfarëdo pëlqimi/konfirmim të shkruar apo verbal nga Universiteti i Gjilanit.

Neni 8 NJOFTIMET DHE NDRYSHIMET

- 8.1** Të gjitha njoftimet dhe komunikimet në lidhje me këtë Marrëveshje do të shkëmbehen personalisht dhe në formë të shkruar dhe/apo përmes postës elektronike, në mes të personave kontaktues të përcaktuar nga Banka dhe Universiteti për implementimin e kësaj Marrëveshje.
- 8.2** Të gjitha njoftimet dhe shkresat tjera në lidhje me dhe për zbatimin e kësaj Marrëveshje do të dërgohen në adresat përkatëse të Bankës dhe Universitetit të Gjilanit:

Gjilan

**Për Bankën:
Banka për Biznes Sh. A.**

Rr. Ukshin Hoti, nr.128
100000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Dhurata Robaj
dhurata.robaj@bpbbank.com

+383 38 620 620

**Për Universitetin :
Universiteti "Kadri Zeka"**

Rr. Zija Shemsiu pn
60000 Gjilan,
Republika e Kosovës

Artan Dermaku
prof.artan.dermaku@uni-gjilan.net

+383 49 120 901

- 8.3** Çfarëdo ndryshimi dhe/apo plotësimi i kësaj Marrëveshje mund të bëhet vetëm me pajtimin e të dy Palëve, për të cilin ndryshim dhe/apo plotësim Palët do të nënshkruajnë aneks të veçantë ku saktë përshkruajnë ndryshimet dhe/apo plotësimet e tilla. Aneksi i tillë do të jetë i vlefshëm vetëm kur nënshkruhet nga të dyja Palët, siç është nënshkruar kjo Marrëveshje.

Neni 9

Faqe 4 nga 6



EKSKLUZIVITETI

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ka për qëllim dhe as nuk do të interpretohet si krijim i ndonjë marrëveshje të ekskluzivitetit ndërmjet Bankës dhe Universitetit të Gjilanit. Kjo Marrëveshje nuk do ta kufizojë Bankën dhe/ose Universitetin e Gjilanit e as përfaqësuesit e tyre nga themelimi i bashkëpunimeve të ngjashme, të barabarta ose të njëjta me subjekte dhe palë tjera.

Neni 10 FUQIA MADHORE

Çdo dështim i Bankës apo Universitetit të Gjilanit për të përmbushur obligimet e veta përkatëse sipas kësaj Marrëveshje nuk mund të konsiderohet si shkelje ose mos-përmbushje e obligimeve, nëse një dështim i tillë është shkaktuar nga luftërat ose konfliktet tjera ushtarake, kryengritjet dhe/ose rebelimet, rrënujat civile, bllokadat, embargot, trazirat, epidemitë, tërmetet, stuhitë, vërshimet ose keqësimi i kushteve tjera klimatike, eksplozimet, zjarret ose rrufetë (këtu e tutje referuar si "**Fuqia Madhore**").

Neni 11 LIGJI I APLIKUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

11.1 Kjo Marrëveshje dhe çfarëdo mosmarrëveshje për dhe lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshje, qeveriset në mënyrë ekskluzive nga ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Për çështje që nuk janë paraparë me këtë Marrëveshje zbatohen dispozitat përkatëse të Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

11.2 Për zgjidhjen e çfarëdo mosmarrëveshje ose kontesti eventual lidhur me dhe për zbatimin e kësaj Marrëveshje, është kompetente Gjykata Komerciale në Prishtinë.

Neni 12 MARRËVESHJA E PLOTË

12.1 Banka dhe Universiteti i Gjilanit pajtohen dhe pranojnë që kjo Marrëveshje përmban marrëveshjen e plotë në mes Universiteti i Gjilanit dhe Bankës dhe asnjë marrëveshje tjetër, e shkruar dhe/apo e pa shkruar, përfaqësim, premtim dhe/apo negociata paraprake e dhënë goftë nga Universiteti i Gjilanit dhe/ose Banka, që nuk është e përfshirë në Marrëveshje, nuk do të jenë të obligueshme për Bankën apo Universiteti i Gjilanit.

Banka dhe Universiteti i Gjilanit pajtohen dhe pranojnë së kjo Marrëveshje është nënshkruar me pëlqimin reciprok të lirë dhe serioz dhe as Banka dhe as Universiteti i Gjilanit nuk kanë qenë subjekt të dhunës fizike dhe/apo psikike në mënyrë evidente apo të fshehur, apo subjekt të kushteve jo të favorshme dhe/apo lajthimit të çfarëdoshëm për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje.

Faqe 5 nga 6



Neni 13
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kjo Marrëveshje është përpiluar në gjuhën shqipe, në 2 (dy) kopje të të njëjtës përmbajtje, nga një (1) kopje për Bankën dhe një (1) për Universitetin e Gjiçanit.

Ne, palët në këtë Marrëveshje, me nënshkrim deklarojmë se i kemi lexuar dhe kuptuar si dhe i kemi pranuar pa asnjë vërejtje të drejtat dhe detyrimet që dalin nga e njëjta Marrëveshje.

Për Bankën:

Pen: [Signature]

Dhurata Robaj,
Udhëheqëse e Departamentit të
Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve

Për Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiçan:

[Signature]

Rektor

Banka për Biznes Sh.A

Universiteti "Kadri Zeka" Gjiçan

Data:

